*MA*

**SILABUSI I LËNDËS: AUTOR I ZGJEDHUR II**

| Të dhëna bazë për lëndën | |
|---|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti I Filologjisë: Departamenti I gjuhës dhe i letërsisë gjermane |
| Titullii lëndës: | Autori i zgjedhur II |
| Niveli: | Master |
| Statusi i lëndës: | E detyrueshme |
| Viti i studimeve: | Viti I, Master |
| Numri i orëve në javë: | 2 + 0 |
| Vlera në kredi - ECTS: | 3 |
| Koha dhe vendi: | |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. dr. Naim Kryeziu |
| Detajet kontaktuese: | naim.kryeziu@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda "*Autori i zgjedhur 2*" ka për qëllim të trajtojë një autor të rëndësishëm të letërsisë gjermane. Trajtimi intensiv i një autori të veçantë brenda një semestri mësimor krijon mundësinë për t'iu qasur më nga afër autorit të zgjedhur, duke analizuar veprën e plotë të tij, ose, së paku, pjesën më të madhe të saj. Kjo lëndë do të merret me autorë që jo vetëm kanë fituar famë edhe ndër autorët më të mëdhenj të letërsisë botërore, por edhe që vepra e tyre ka bërë jehonë dhe ka ndikuar në zhvillimin e kësaj letërsie. Në qendër të kësaj lënde do të jenë autorët më kryesorë që i takojnë fundit të shekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI, sidomos ato vepra të tyre që mbahen si më të rëndësishmet e njëherazi si më të njohurat dhe me ndikimin më të madh në letërsinë gjermane e përgjithësisht në letërsinë botërore. Këtu bëhet fjalë për shkrimtarë të tillë siç janë Tomas Mani, Franc Kafka, Stefan Cvajgu, Elias Kaneti, Bertolt Brehti, Jozef Roti, Herman Hesja, Patrik Syskindi, Hajnrih Bëli, Bernhard Shlinki, Jurk Bekeri, Fridrih Dyrrenmati, Max Frishi, Erih Maria Remarku , Gynter Grasi, etj. |
| Qëllimet e lëndës: | Lënda "Autori i zgjedhur II" synon që studenti:<br>• të njihet me konceptet dhe me metodologjitë kryesore për analizën e veprës letrare.<br>• të njihet me jetën dhe me veprën e autorit të zgjedhur.<br>• të njihet me temat më kryesore që trajton autori në veprën e vet. |

| | |
|---|---|
| | • të njohë rrethanat dhe kushtet ku e ka shkruar autori veprën letrare<br>• të zbulojë mesazhin kryesor të veprës<br>• të mësojë se ç'janë tema, motivi, narratori, fabula, etj. te një vepër letrare<br>• të njihet me llojet e romaneve.<br>• të mësojë për jehonën dhe për ndikimin e një vepre letrare. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Pas përfundimit të këtij kursi, studenti duhet të ketë njohuri të mjaftueshme:<br>• për ata autorë kryesorë të letërsisë moderne gjermane që zënë vend të rëndësishëm në letërsinë botërore<br>• për veprën e plotë të autorit të zgjedhur,<br>• për rëndësinë e veprës së autorit përkatës në letërsinë gjermane e botërore,<br>• për të hartuar një punim të hollësishëm seminari rreth ndonjërës nga veprat e zgjedhura të autorit në fjalë,<br>• për të zhvilluar aftësinë e mendimit të pavarur lidhur me një vepër letrare dhe të bërë debat rreth një teme nga letërsia,<br>• për të shprehur qartë mendimin lidhur me një temë të shtjelluar në një vepër letrare. |

| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
|---|---|---|---|
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/ushtrime | | | |
| Punë praktike | | | |
| Përgatitje për test intermediar | 45 | 5 | 2.25 |
| Konsultime me mësimdhënësin | 15 | 15 | 2.25 |
| Punë në terren | | | |
| Testi, punim seminari | 2 | 11 | 22 |
| Mësimi vetjak (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 5 | 10 |
| Detyrë shtëpie | 2 | 5 | 10 |
| Përgatitja për provim përfundimtar | 5 | 1 | 5 |
| Koha e duhur për vlerësim (teste, kuice, provimi përfundimtar) | 1 | 1 | 1 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Projektet, prezantimet, etj. | 1 | 1 | 1 | |
| **Total** | | | **83.50:25= 3.34**<br>**3 ECTS** | |

| | |
|---|---|
| Format e mësimdhënies dh të mësimnxënies: | Mësimi zhvillohet me ligjërata dhe me shpjegime përkatëse. Gjatë shpjegimeve zbatohet metoda ndërvepruese. Në fillim të ligjëratës zhvillohet gjithmonë debat për leksionin e mëparshëm. Në fund të ligjëratës bëhet një përsëritje e përbashkët e leksionit pasues. |
| Metodat e vlerësimit: | • Pjesëmarja aktive dhe detyrat 20 %<br>• Testi i parë 30 %<br>• Provimi përfundimtar (me shkrim/me gojë) 50% |
| Literatura | |
| Literatura bazë: | Caktohet pas zgjedhjes së autorit dhe të veprës. |
| Literatura shtesë: | Caktohet pas zgjedhjes së autorit dhe të veprës. |

Plani i detajuar i mësimit

| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
|---|---|
| *Java e parë* | Jeta dhe formimi intelektual i autorit |
| *Java e dytë* | Vepra e autorit |
| *Java e tretë* | Tema që trajtohet në vepër |
| *Java e katërt* | Narratori në veprën e autorit |
| *Java e pestë* | Fabula në veprën e autorit |
| *Java e gjashtë* | Karakteri i figurave në veprën letrare |
| *Java e shtatë* | Çfarë dukuri shoqërore trajton autori |
| *Java e tetë* | Motivi kryesor i lindjes së veprës letrare |
| *Java e nëntë* | Ideja e autorit në veprën letrare |
| *Java e dhjetë* | Çfarë ndikimi ka vepra e autorit |
| *Java e njëmbëdhjetë* | Qëllimet kryesore të autorit në veprën letrare |
| *Java e dymbëdhjetë* | Përcaktimi i karakterit të veprës |
| *Java e trembëdhjetë* | Rëndësia e veprës së autorit në letërsinë gjermane e botërore |
| *Java e katërmbëdhjetë* | Vlerësimi kritik i veprës |
| *Java e pesëmbëdhjetë* | Jehona e veprës |

| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes |
|---|
| Studentët duhet të vijnë me kohë në auditor, sepse ardhja me vonesë sjell ndërprerjen e mësimit dhe pengon, çrregullon e shpërqendron vëmendjen e studentëve. Gjatë orës së mësimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike, sepse shkaktojnë zhurmë ose pengesa të tjera. |

*Hartoi: Prof. dr. Naim Kryeziu/04.04.2025/NKr*